



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORIJA E INSPEKTORATIT

Datë :	05.04.2016
Referencë	11-344/3
Për :	Kryetar i Komunes-z. Imri Ahmeti
Përmes :	Drejtëpërsëdrejti
Nga :	Drejtori i Drejtorisë të Inspektoratit - Imer Rrustemi
Lënda :	RAPORTI MUJOR-MARS

Gjatë këtij muaji kemi punuar rreth identifikimit të bizneseve të pa regjistruara MTI, dhe pa pranime teknike të lokaleve afariste për plotësimin e kushteve tekniko higjeno sanitare, kemi kontrolluar marketet ushqimore nëpër qytet dhe fshatra, bizneset rreth aftashmërisë së mallit ,kushtet e ruajtjes së mallit, faturat e furnizimit me mallë dhënien e faturave për shërbimet e ofruara konsumatorëve, çmimet e vendosura në artikuj dhe krahasimi i çmimeve të sektorëve me atë të arka në dalje, në veçanti një aksent i veçantë ishte gjatë këtij muaji ndalimi i evazionit fiskal.

Kemi bërë disa pika kontrolli në disa rrugë tranzitore të Lipjanit e në veçanti ato që kanë lidhje me fshatrat e shumicës së komunës sonë ku i kemi ndaluar disa transportues të mallrave të ndryshëm ku i kemi kontrolluar rreth afatëshmerisë së mallit, kushtet e ruajtjes së mallit, faturat e mallit, ku të disa transportues kemi hasur duke ushtruar tregti ambulante me shumicë ku Ligji për tregtinë e brendshme e ndalon këtë veprimtari nën 6, 10, 38.1 i ligjit për tregtinë e brendshme 2004/18 pasi që kemi hasur në këto parregullsi kemi iniciuar procedurë kundërvajtjeje për ata shitës ambulantiv me shumicë.

Në vazhdimësi për çdo javë është duke u përcjellë tregu i kafshëve si dhe ai i gjelbërt rreth dhënies së biletave dhe ndonjë parregullsie të mundshme në baze të kontratës që posedon kompania “Algemi” me Drejtorin komunal të Prokurimit.

Në kuadër të sanitarisë kemi inspektuar subjekte të ndryshme afariste: kafiterit të ndryshme në rrethine dhe qytet ku në njërin prej tyre në periferi të qytetit kemi gjetur mall me afat të skaduar pije të cilën automatikisht i kemi asgjësuar, ku ndaj pronarit të subjektit janë marrë të gjitha masat ligjore duke e quar lëndën direkt në Gjykatë. Janë inspektuar gjithashtu edhe disa markete në qytet ku në njërin nga markete është gjetur mall me afat të skaduar, ndaj të cilit janë marrë masat ligjore. Në vazhdimësi është duke u përcjellë edhe thertorja e vetme e cila është në territorin komunal sonë “Partner Kosova” në të cilën në vazhdimësi janë therrur kafshët e shëndosha para therrjes si dhe pas therrjes, mishi në vazhdimësi është nën kontrollin e Inspektorit Komunal.

Gjatë muajit Mars dhe muajit prill inspektorati në agjendën e vet do të përgatit aksionet e ndryshme rreth formës së largimit të mbeturinave nëpër shumicën e fshatrave, një agjendë rreth eliminimit (largimit) të mbeturinave nëpër deponit ilegale të fshatrave me qëllim të ruajtjes së mjedisit. Në vazhdimësi jemi në kontakt edhe me organet tjera përkatëse komunale si dhe kryetarin e Komunës së si: të gjejmë mjete forma apo kompani të mundshme për eliminimin e mbeturinave të ndryshme me ndonjë kompani e në këtë mënyrë ta mbrojmë shëndetin e qytetareve të komunës sonë.

Inspektoret e mjedisit në vazhdimësi janë pothuajse në çdo fshat duke u takuar me qytetaret dhe kryetaret e fshatrave në lidhje me mbrojtjen mjedisit meqenëse ambienti në shumicën e fshatrave është i stërmbytur me mbeturina të llojeve të ndryshme inerte të amvisërisë si dhe plehra të shtazëve.

Në vazhdimësi ju kemi përgjigjur qytetareve në kërkesat e tyre në lidhje me kërkesën e tyre për shkak të bllokimit të rrjetit të kanalizimit. Kompania e ujësjellësit na është përgjigjur gjithmonë në çdo vend ku ka pasur nevojë për dblokim të kanalizimit. Një palë gjatë këtij muaji është ndëshkuar për shkak të mos zbatimit të urdhërimit të inspektorit duke hedhur mbeturina në natyrë.

Gjatë muajit Mars kemi filluar inspektimin e kafiterive të cilat i shfrytëzojnë hapësirat publike me të vetmin qëllim që këto biznese të kryejnë obligimet financiare të komunës.

Gjatë këtij muaji është bërë inspektimi në Aeroportin Ndërkombëtar “ Adem Jashari “ në Vrellë ku kemi bërë disa pika kontrolli në lidhje me auto-taksi të cilët po tentojnë të ushtrojnë veprimtari ilegale, po ashtu është bërë edhe kontrollimi i auto-taksive të cilët ushtrojnë veprimtari legale në bashkëpunim me policinë kufitare të Aeroportit, si dhe transportuesit publik-autobusët

Inspektoret e ndërtimit kanë përcjellur të gjitha punimet e objekteve ndërtimore me leje në baze të projekteve që posedojnë. Një gjë është me rëndësi që në territorin e komunës sonë: nuk është lejuar dhe nuk do të lejohet kurrë që të ndërtohet pa leje ndërtimi.

Çdo gjë është nën kontrollin tonë kështu që qytetëtarët tani janë të vetëdijësuar se: nuk mund të ndërtohet pa leje ndërtimi.

Gjatë këtij muaji inspektori i bujqësisë ka bërë inspektimin e barnatoreve bujqësore të cilat merreshin me tregtimin dhe shitjen e qepujkave, njëkohësisht është verifikuar zbatimi i urdhëresave të dhëna me procesverbale dhe aktvendime, është inspektuar një market me veprimtari tregtare ku kemi verifikuar afatshmërinë e artikujve ushqimor me prejardhje bimore sipas Ligjit për Ushqimin Nr . 03/L-016 dhe kemi kërkuar Certifikatat Fitosanitare për Uthullën sipas të njëjtit Ligj.

Gjatë këtij muaji është verifikuar afatshmëria e artikujve ushqimor me prejardhje bimore sipas Ligjit për Ushqimin Nr.03/L-016 dhe kemi kërkuar Certifikatat Fitosanitare për Uthllën sipas të njëjtit Ligji, njëkohësisht kam verifikuar zbatimin e urdhëresave të dhëna ditë më parë tek bizneset që ushtrojnë aktivitet bujqësorë, si dhe janë inspektuar tokat bujqësore ku ju është ndërruar destinimi, janë inspektuar markete të cilat tregtojnë dhe shesin produkte ushqimore me prejardhje bimore.

Gjithashtu është bërë inspektim i bletarive me ftesë të fermerëve për verifikimin e kushteve si kusht aplikimi për subvencione.

Të dhënat statistikore më të hollësishme janë të paraqitura në tabelën e më poshtme:

Pasqyra tabelare e punës për muajin -MARS

Inspektorët																			
Gjithsej	Inspektime me procesverbal	Pranime teknike	Fletëparaqitje për kundërvajtje	Inspektime për pirjen e duhanit	Vërejtje, njoftime	Inspektime për orar të punës	Lëndë e ekzekutuara gjyqësore	Inspektime të përbashkëta	Pelqim sanitar	Inspektim i auto-taxi	Menaxhim i tregjeve dhe inspektim i biletave	Aktivendime- ndalesa,urdhëresa	Kërkesa, pune me palë	Mbyllje e përkohshme e lokalit afarist	Inspektim i kafshëve në thetore	Inspektime me polici	Inspektim për farëra,plehradhe pesticide	Mall me afat të skaduar	Biznese të pajisjeshme,pa pranime teknike,per çmime
Biznesit	612	31	11	4	61	69	7	48			73	61	207	1		10			29
Ambientit	317	26		1		3		137					136			14			
Bujqësisë	174	16				72		38					48						
Ndërtimtarisë	127	24		1				68			4	2	28						
Trafikut	485	54		6		83	7	35		132	10		74			84			
Sanitar	273	19		6	63	40		101	1				30		13			106€	
Gjithsejtë	1988	170	11	18	124	267	14	427	1	132	87	63	523	1	13	108		106€	29